



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 662, datë 02.11.2023**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 280, DATË 10.12.2019 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR “PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR MEDIAT”, I NDRYSHUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Vendimet e tij nr. 590 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin gjyqësor”; nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, të ndryshuar me vendimet nr. 292, datë 06.07.2021; nr. 424 datë 29.09.2021; nr. 254 datë 07.07.2022; nr. 515 datë 21.11.2022 dhe nr. 101 datë 06.03.2023, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e pikës 1 të Vendimit nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ndryshuar, si më poshtë:

Caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat

Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit

- z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- znj. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
- znj. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
- z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
- znj. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

Në Juridiksionin e Apelit për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

- z. {...}- Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

2. Ngarkohen Gjyqtarët e caktuar për Mediat dhe gjykatat përkatëse të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**